



**REPUBLIKA E KOSOVËS - PRESIDENTI**  
**REPUBLIC OF KOSOVO - THE PRESIDENT**  
**REPUBLIKA KOSOVA - PREDSEDNIK**

**EKIPI PËRGATITOR PËR THEMELIMIN E KOMISIONIT PËR TË VËRTETËN DHE PAJTIMIN**  
**PRIPREMNI TIM ZA OSNIVANJE KOMISIJE ZA ISTINU I POMIRENJE**  
**PREPARATORY TEAM FOR THE ESTABLISHMENT OF THE TRUTH AND RECONCILIATION COMMISSION**

---

**DEKLARATË E EKIPIT PËRGATITOR PËR**  
**THEMELIMIN E KOMISIONIT PËR TË VËRTETËN**  
**DHE PAJTIMIN**

**Prishtinë, 30.08.2018**

Ekipi përgatitor për themelimin e Komisionit për të Vërtetën dhe Pajtimin,  
Në pajtim me Nenin 4 (1.2) të Rregullores së punës së Ekipit përgatitor për themelimin e Komisionit për të Vërtetën dhe Pajtimin (12 korrik 2018), në takimin e mbajtur më 30 gusht 2018, miraton si në vijim:

## **DEKLARATËN E EKIPIT PËRGATITOR PËR THEMELIMIN E KOMISIONIT PËR TË VËRTETËN DHE PAJTIMIN**

### **Iniciativa për Komisionin e të Vërtetës dhe Pajtimin në Kosovë**

Dy dekada pas luftës së fundit në Ballkan, ka ardhur koha për një paqe të qëndrueshme. Bashkëjetesa dhe bashkëpunimi pa zëvendësuar tregimet nga e kaluara është e mundur. Kjo do të arrihet duke u munduar për përfshirje aktive të të gjithëve në proceset e ndërtimit të paqes.

Ne, populli i Kosovës, kemi vuajtur për shumë kohë pasojat e së kaluarës së dhunshme. Nëpërmjet vuajtjeve kemi mësuar se sa e çmuar është paqja.

Hapa të rëndësishëm janë bërë në trajtimin e së kaluarës në Kosovë. Kjo ka përgatitur shoqërinë që të ndërmer hapin e ardhshëm të madh, duke filluar një proces shërimi përmes kërkimit të së vërtetës. Kjo do të hapë rrugën për gjeneratat e ardhshme për të ndërtuar dhe mbajtur një paqe të qëndrueshme.

Pas konsultimeve me publikun, Presidenti i Kosovës ka marrë iniciativën për themelimin e Komisionit të së Vërtetës dhe Pajtimin në Kosovë.

Mekanizmat e së Vërtetës dhe të Pajtimin në mbarë botën i kanë ndihmuar shoqëritë të tejkalojnë vuajtjet dhe ndarjen e shkaktuara nga luftërat dhe dhuna dhe të hapin një kapitull pajtimi, ndërtimi dhe ruajtjes së paqes. Mekanizmat e të Vërtetës dhe Pajtimin nuk e zëvendësojnë drejtësinë, por ato sigurojnë mjete për trajtim të drejtë dhe të barabartë të të gjitha palëve të prekura nga konfliktet e dhunshme.

Pavarësisht arritjeve të prekshme në ndërtimin e paqes, komunitetet në Kosovë vazhdojnë të jetojnë të ndarë, të mbyllur në pikëpamjet e tyre antagonistike dhe interpretimet e së kaluarës. Ka ardhur koha që kjo të bëhet e shkuar.

## **Qëllimi i Komisionit të së Vërtetës dhe Pajtitimit në Kosovë**

Komisioni për të Vërtetën dhe Pajtimin në Kosovë synon të dokumentojë dhe vendosë fakte për shkeljet e të drejtave të njeriut që ndodhën gjatë së dhunës së kaluarës së rishtë, rikthimin e dinjitetit të viktimave të të gjitha komuniteteve, të kontribuojë në transformimin shoqëror për të parandaluar përsëritjen e shkeljeve dhe abuzimeve të pësuar.

## **Vlerat dhe parimet e Komisionit të së Vërtetës dhe Pajtitimit**

Komisioni i të Vërtetës dhe Pajtitimit:

- Do të respektojë të drejtat e njeriut dhe dinjitetin e të gjithë personave;
- ka një fokus të veçantë tek viktimat civile: i mbron, i njeh dhe i fuqizon;
- Është i përbërë nga njerëz me integritet të lartë, të përzgjedhur me një proces transparent sipas standardeve më të larta të etikës profesionale;
- është i pavarur dhe vendimet e marra nuk ndikohen politikisht;
- do të jetë llogaridhënës, I përgjegjshëm, i çastshëm dhe i hapur për të gjithë qytetarët e Kosovës dhe palët e interesuara;
- parandalon racizmin, seksizmin dhe diskriminimin gjinor gjatë procesit, në punën e tij dhe në rezultatet e procesit;
- do të ndjekë ekzaminimin rigoroz dhe metodik të fakteve dhe ngjarjeve të së kaluarës, në përputhje me drejtësinë procedurale.

## **Puna përgatitore për themelimin e Komisionit të së Vërtetës dhe Pajtitimit**

Me qëllim të themelimit të Komisionit të së Vërtetës dhe Pajtitimit, një Ekip Përgatitor u emërua nga Presidenti i Kosovës, i cili përbëhet nga 9 anëtarë, me shumicë nga shoqëria civile, por edhe me praninë e Zyrës së Presidentit të Kosovës, Parlamentit të Kosovës dhe Qeverisë së Kosovës. Ekipi Përgatitor do të kryejë konsultime publike, takime me palët kyçe politike dhe civile në Kosovë, me qëllim të hartimit të dokumenteve të nevojshme për funksionalizimin e Komisionit të së Vërtetës dhe Pajtitimit.

## **Vlerat dhe Parimet e Ekipit Përgatitor**

Ekipi Përgatitor bazon punën e tij në katër vlera kryesore: përfshirjen, barazinë, integritetin dhe transparencën.

Ekipi Përgatitor përfaqëson interesin e të gjitha komuniteteve që jetojnë në Kosovë, në mënyrë të barabartë.

Ekipi vepron me transparencë dhe integritet në vendosjen e Komisionit të së Vërtetës dhe Pajtitimit në Kosovë.

Prishtinë, 30 gusht 2018